
 Republika e Kosovës	Drejtorati për Shëndetësi		 Komuna e Istogut
	Nr.06/2022	Data: 16.09.2022	



OENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE – ISTOG

Në mbështetje të nenit 8 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr 03/L-212 e miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, nenit 4 i Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017, Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik dhe neni 15, Statutit të Q.K.M.F në Istog shpall:

K O N K U R S

1. Titulli i vendit të punës: Mjek-e i/e Mjekësisë së Përgjithshme.

Numri i referencës: Nr.833/2022

Numri i Ekzekutuesve: 4 (katër)

Niveli i Pagës: Koeficienti 7.2

Kohëzgjatja e Emërimit: Në kohë të pacaktuar, (6 Muaj Periudha Provuese)

Orët e Punës: 40 Orë në javë.

Lloji i pozitës: I karrierës.

Punët dhe detyrat:

1. Sigurimi i shërbimeve shëndetësore në mbrojtjen parësore;
2. Kujdesi për shëndetin e pacientëve, përshkruan dhe administron tretmanet, medikamentët dhe i zbaton masat tjera shëruese;
3. Ndhmon në parandalimin e sëmundjeve dhe çrregullimeve duke këshilluar pacientët dhe popullatën në lidhje me pastërtinë dhe shëndetin në përgjithësi;
4. Jep udhëzime me shkrim dhe me gojë për trajtim të pacientit;
5. Përshkruan dhe administron medikamente;
6. Udhëzon pacientët të specialistët mjekësorë dhe shkëmben të dhënat relevante mjekësore
7. Përpilon me shkrim raportet lidhur me punën dhe veprimet e tij;
8. Ndërmerr aktivitetet për edukimin shëndetësorë të popullatës;
9. Kryen detyra të tjera ashtu si kërkon mbikqyrësi në mbarëvajtjen e punës ku është i punësuar;
10. Ndhmon dhe siguron mirësjellje e kujdes të veçant në lëmin në të cilin është trajnuar
11. Mban kujdestarinë sipas radhës dhe kryen punë të tjera sipas kërkesës së eprorit;
12. Kryen detyra të veqanta në lidhje me profesionin e tij.

Shkollimi i kërkuar: Diplomë Universitare - Fakulteti i Mjekësisë drejtimi - Mjekësia e Përgjithshme.

Aftësit/ përvoja dhe atributet e tjera:

1. Të jetë i licencuar;
2. Përvoja e punës e dëshirueshme;
3. Shkathësi për komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
4. Shkathësi hulumtuese, analitike vlerësuese dhe dhënja e këshillave profesionale;
5. Aftësi për përmbushjen e detyrave dhe punëve nën presion.
6. Njohja e punës me kompjuter e dëshirueshme ;

Dokumentët e kërkuara:

Diploma e fakultetit të Mjekësisë;
Çertifikatën e Licencës;
Dëshmi për përvojën e punës nëse ka;
Dokumenti i Identifikimit;
Çertifikata që nuk jeni nën hetime.

2. Titulli i vendit të punës: Infermier/e.

Numri i Referencës: Nr.834/2022

Numri i ekzekutuesve: 1 (një)

Niveli i pagesës: Koeficienti 4.8

Kategoria funksionale: Niveli Profesional

Periudha e kontratës është: Në kohë të pacaktuar, (6 Muaj Periudha Provuese)

Orari i Plotë; 40 orë në javë.

Lloji i pozitës: I karrierës.

Punët dhe detyrat:

Ne bashkëpunim me anëtarët e tjerë të ekipit të mjekësisë familjare, ofron një sere shërbimesh shëndetësore infermiereje duke përfshirë kujdesin institucional, shtëpiak, për individ dhe familje dhe komunitete si:


- Kujdes prenatal, Intrapartal, postpartal;
- Ofron kujdes për nëna dhe fëmije;
- Ofron shërbime për fëmije dhe të rinj, invalid dhe të moshuar, përkujdesje për të sëmuret kronik;
- Ofron shërbime rehabilituese të shëndetit mental të bazuar në bashkësi, etj;
- Te caktoj, planifikoj, implementoj dhe vlerësoj kujdesin ndaj të sëmurit ne përputhje me politiken e aprovuar;
- Te iu japë pacienteve informata të sakta dhe të qarta lidhur me kujdesin i cili iu ofrohet atyre;
- Të kontribuoi ne mbajtje të pastërtisë dhe higjienës në mjedisin ku punon dhe të punoj gjithnjë në përputhje me udhëzuesit mbi kontrollin e infeksionit;
- Realizon programe të promovimit shëndetësor;
- Ndhmon dhe siguron mirësjellje e kujdes të veçant në lëmin në të cilin është trajnuar;
- Mban kujdestarin sipas radhës dhe kryen punë të tjera sipas kërkesës së eprorit;
- Kryen detyra të veçanta në lidhje me profesionin e tij.

Kualifikimet, shkathtësitë kyqe, aftësitë dhe përvoja.

- Shkolla e Mesme e Mjekësisë - Drejtimi përgjithshëm/Fakulteti i Infermierisë - bachelor,
- Minimum stazhi i Obliguar Profesional;
- Të jetë i licencuar.
- Përvoja e punës e dëshirueshme.

Dokumentët e kërkuara:

Diploma e shkollës së mesme ose e fakultetit;
Licencën e Punës
Dëshmi për përvojën e punës.
Dokumenti i Identifikimit
Dëshmi nga gjykata që nuk je nën Hetime



3. Titulli i vendit të punës: Teknik/e i/e Laboratorit, në QKMF.

Numri i Referencës: Nr.835/2022

Numri i ekzekutuesve: 1 (një)

Niveli i pagesës: Koefficienti 4.8

Kategoria funksionale: Niveli Profesional

Periudha e kontratës është: Në kohë të pacaktuar (6 Muaj Periudha Provuese)

Orari i Plotë; 40 orë në javë.

Lloji i pozitës: I karrierës

Punët dhe detyrat:

- Bënë pregaditjen për sterilizimin e instrumenteve të nevojshme laboratorike për marrjen e materialit laboratorik nga pacientët,
- Varësisht nga testet që kryhen në laborator, të merr, të pregadisë, të analizoj dhe të asgjesoje në menyrë të sigurt të gjitha mostrat klinike,
- Shkruan, shpërndan dhe arkivon rezultatet e testeve të ndryshme laboratorike,
- Përdorë dhe mirëmban të gjitha paisjet laboratorike ,
- Jep këshilla pacientëve për mënyrën e marrjes së mostrave,
- Pregaditë , klasifikon dhe sterilizon enët laboratorike
- Kryen edhe punë të tjera profesionale specifike për shërbimin përkatës.

Kualifikimet, shkathtësit kyqe, aftësit dhe përvoja.

- Shkolla e Mesme e Mjekësisë - Drejtimi teknik i laboratorit /Fakulteti bachelor i bio-kimise laboratorike,
- Minimum stazhi i Obliguar Profesional;
- Të jetë i licencuar.
- Përvoja e punës e dëshirueshme.

Dokumentët e kërkuara:

Diploma e shkollës së mesme ose e fakultetit;

Licencën e Punës

Dëshmi për përvojën e punës.

Dokumenti i Identifikimit

Dëshmi nga gjykata që nuk je nën Hetime

4. Titulli i vendit të punës: Teknik/e i/e Farmacisë, në QKMF.

Numri i Referencës: Nr.836/2022.

Numri i ekzekutuesve: 1 (një)

Niveli i pagesës: Koefficienti 4.8

Kategoria funksionale: Niveli Profesional

Periudha e kontratës është: Në kohë të pacaktuar (6 Muaj Periudha Provuese)

Orari i Plotë; 40 orë në javë.

Lloji i pozitës: I karrierës

Punët dhe detyrat:

- Mirëmbajtja dhe sigurimi i funksionalitetit të farmacive nën mbikëqyrje të Ministrisë së Shëndetësisë apo Drejtorive komunale për shëndetësi:
- Siguron mirëmbajtjen e vazhdueshme profesionale të farmacisë duke klasifikuar sipas rendit të gjitha produktet farmaceutike dhe profesionale;20%

- Mban evidencë ditore për të gjitha produktet farmaceutike dhe medicinale që janë përdorur, duke qartësuar vendin e shfrytëzimit të secilit veç e veç; 20%.
- Harton listën e kërkesave për furnizime me produkte medicinale dhe farmaceutike; 15%.
- Ndihmon përgjegjësinë e farmacisë në menaxhimin e farmacisë; 15%
- Asiston përgjegjësinë e farmacisë me rastin e hartimit të raporteve periodike të punës; 15%;
- Bashkëpunon me shërbimet e tjera të shërbimet tjera të Spitalit/QKMF dhe merr kërkesa për nevojat e veçanta të tyre; 10%
- Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrsi;5%..

Kualifikimet, shkathtësit kyqe, aftësit dhe përvoja.

- Diploma e shkollës së mesme - drejtimi teknik i farmacisë, trajnim përkatës dhe së paku katër (4) vite përvojë pune në fushën përkatëse teknike ose administrative;
- Njohuri dhe përvojë në fushën e farmacisë dhe produkteve farmaceutike;
- Njohuri e rregulloreve së punës së farmacisë;
- Aftësi për punuar me orar të zgjatur dhe në ndërrimin e natës.
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Internetit)

Dokumentët e kërkuara:

Diploma e shkollës së mesme drejtimi Farmaci;
 Liçencën e Punës
 Dëshmi për përvojen e punës.
 Dokumenti i Identifikimit
 Dëshmi nga gjykata që nuk je nën Hetime.

5. Titulli i vendit të punës: Higjienist/e – në QKMF.

Numeri i References: Nr.837/2022

Numeri i Ekzekutuesve: 1 (një)

Koeficienti: Koeficienti 4

Periudha e kontratës është: Në kohë të pacaktuar,(6 Muaj Periudha Provuese)

Orari i Plotë; 40 orë në javë.

Lloji i pozitës: I karrierës.

Përshkrimi i vendit të punës;

- Bën pastrimin e ordinancave, koridoreve dhe lokaleve të punës;
- Mbledh hedhurinat në lokalet e punës dhe i deponon në vendin e caktuar;
- Bën pastrimin e nyjeve sanitare;
- Pastron oborrin e objektit;
- Në ordinancë dhe lokale të Administratës bënë pastrimin e inventarit, mjeteve të punës dyshemeve, mureve, dritareve, dhe inventarit tjetër që gjendet në lokal - ordinancë;
- Kujdeset për ruatjen, mirëmbajtjen e inventarit dhe mjeteve të punës;
- Punët e rëndomta të pastrimit i kryen për çdo ditë, ndërsa një herë në muaj bënë pastrimin e përgjithshëm(gjeneral) të ordinancave, inventarit dhe mjeteve të tjera të punës;
- Për punën e vet i përgjigjet Shefit të Shërbimit dhe Drejtorit.

Dokumentet e kërkuara:

Diploma e shkollës së mesme;
 Dokumenti i Identifikimit
 Dëshmi nga gjykata që nuk je nën Hetime

6. Titulli i vendit të punës: Shofer në OKMF.

Numri i Referencës: Nr.838/2022.

Numri i ekzekutuesve: 1 (një)

Niveli i pagesës: Koefficienti 4

Kategoria funksionale: Niveli Profesional

Periodha e kontratës është: Në kohë të pacaktuar,(6 Muaj Periudha Provuese)

Orari i Plotë; 40 orë në javë.

Lloji i pozitës: I karrierës

Qëllimi i vendit të punës: Të sigurohen shërbimet të vozitjes për nevoja të Institucionit Mjekësor.

Punët dhe detyrat:

- Sipas urdhërave të epnoreve të tij kryen transportin e personelit, të të mirave materiale, mjeteve themelore dhe materialit tjetër hargjues deri në destinacionin e caktuar.
- Përkujdeset për mirëmbajtjen e rregullt automjetit.
- Kujdeset për pastërtinë e automjetit.
- Gjatë vozitjes respekton rregullat e komunikacionit.
- Pranon dhe dorëzon automjetin me protokoll ditor.
- Përkujdeset për furnizim me kohë të pjesëve rezerve si dhe aparatit për zjarr-fikje dhe aparatit.
- Përdor mjete mbrojtëse në punë.
- Në urdhër-udhëtim shënon sakte kohën e nisjes dhe destinacionin, si dhe kohën e kthimit dhe kilometrat e kaluara.
- Mbanë evidencë mbi kilometrat e kaluara derivatet e shpenzuara dhe përkujdeset për servisimin e automjetit.
- Përgjigjet shpejtë në detyrat që i ngarkohen.
- Kryen edhe detyra tjera të vozitësit të cilat ia cakton udhëheqësi.

Kualifikimet, shkathtësitë kyqe, aftësitë dhe përvoja:

- Të ketë diplomën e shkollës së mesme, 4 vite përvojë profesionale.
- Kategorinë përkatëse të vozitjes (B,C).
- Të jetë në gjendje të mirë psiko-fizike.
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion.
- Shkathtësi në komunikim dhe në veprim.

Dokumentet e kërkuara:

Diploma e shkollës së mesme;
Dëshmi për përvojën e punës.
Dokumenti i Identifikimit
Dëshmi nga gjykata që nuk je nën Hetime.

7. Titulli i vendit të punës – Zyrtar/e Ligjor/e në QKMF.

Numri i Referencës: Nr.839/2022.

Numri i ekzekutuesve: 1 (një)

Niveli i pagesës: Koefficienti 6

Kategoria funksionale: Niveli Profesional

Periudha e kontratës është: Në kohë të pacaktuar,(6 Muaj Periudha Provuese)

Orari i Plotë; 40 orë në javë.

Lloji i pozites: I karrierës.

Qëllimi i vendit të punës: Hartimi, zhvillimi dhe harmonizimi i legjislacionit dhe akteve tjera ligjore si dhe dhënia e këshillave për menaxhmentin dhe njësitë organizative të ministrisë, me mbikëqyrje të kufizuar.

Punët dhe detyrat:

- Ndhmon mbikëqyrësin dhe zyrtarin e lartë ligjor në hartimin e planeve të punës për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të njësisë dhe jep rekomandime lidhur me realizimin objektivave të njësisë; 10%
 - Harton dhe zhvillon legjislacionin dhe aktet tjera juridike, kontrata, marrëveshje nga fushë veprimtaria e ministrisë; 20%
 - Bën hulumtime dhe analiza që ndërlidhën me ligjet dhe aktet nënligjore brenda fushës së përgjegjësisë së ministrisë dhe jep rekomandime, këshilla, udhëzime për menaxhmentin e ministrisë; 15%
 - Bënë pajtueshmërinë e projektligjeve dhe të akteve të tjera nënligjore me Kornizën Kushtetuese dhe me legjislacionin në fuqi në Kosovë dhe legjislacionin e Bashkimit Evropian si dhe merr pjesë në hartimin e strategjisë legjislative të ministrisë; 15%
 - Kujdeset që përmbajtja dhe forma e projekt akteve normative të jetë e saktë, si nga aspekti gjuhësor dhe teknik si dhe të jenë identike në gjuhët zyrtare; 15%
 - Sipas kërkesës dhe sipas udhëzimeve të nivelit më të lartë jep opinione ligjore si dhe bën hartimin e projekt marrëveshjeve, projektvendimeve dhe projekt akteve të tjera; 10%
 - Bashkëpunon me njësitë tjera brenda ministrisë për aktivitetet që ndërlidhen me fushën e legjislacionit; 10%
- Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi; 5%


Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuar:

- Diploma universitare, fakulteti juridik minimum 2 vite përvojë pune profesionale;
- Njohuri dhe përvojë në hartimin, harmonizimin e legjislacionit dhe akteve tjera juridike;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme në fushat e përgjegjësisë së ministrisë;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;

Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access, Internetit).

Dokumentet e kërkuar:

- Diploma e fakultetit;
- Dëshmi për përvojën e punës.
- Dokumenti i Identifikimit
- Dëshmi nga gjykata që nuk je nën Hetime



Të drejtë për punësim kanë të gjithë personat e moshës madhore të cilët kanë zotësi për të vepruar, janë në posedim të drejtave civile dhe politike , kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë e duhur për kryerjen e detyrave të punës.
Konkursi mbetet i hapur **15 ditë nga dita e shpalljes** në mjetet e informimit.
Kandidatët e interesuar mund ti marrin aplikacionet çdo ditë pune në **Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare –Istog** -Zyra e Shërbimit Juridik dhe aplikacionet e plotësuara dorëzohen në të njejtën zyre.
Me Kandidatët të cilët kanë konkuruar, do të mbahët intervista nga komisioni .
Për datën dhe kohën e mbajtjes së intervistës, kandidatët do të njoftohen me kohë.

Vërejtje: Aplikacionet e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pa kompletuara nuk do të pranohen.



Udhëheqesi i dep. të Mjekësisë Familjare
Dr. TAHIR KALIQANI